



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, Ligjin Nr. 04/L-122, si dhe Ligjin Nr. 08/L-122, nën paragrafit 2 të paragrafit 2 të nenit 64 të Ligjit Nr. 08-L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe Ligjit Nr. 08/L-166 për Tubimet Publike, me datën 15.08.2024, miraton këtë:

**RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 07/2024 PËR FUSHATËN E ZGJEDHJEVE,
MONITORIMIN E FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE DHE DEKLARIMIN FINANCIAR**

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton procedurat për kufizimin e shpenzimeve të fushatës së zgjedhjeve, rregullat e fushatës së zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar të fushatës së zgjedhjeve.

Neni 2
Periudha e fushatës së zgjedhjeve

Fushata e zgjedhjeve fillon tridhjetë (30) ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përfundon me hapjen e qendrave të votimit në ditën e zgjedhjeve në orën 07:00, siç përcaktohet në nënparagrafin 29, të paragrafit 1 të nenit 3 të LZP.

Neni 3
Kufizimi i shpenzimeve gjatë fushatës së zgjedhjeve

1. Sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra), KQZ jo më vonë se pesë (5) ditë pas ditës së shpalljes së zgjedhjeve, merr vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës së zgjedhjeve, duke u bazuar në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve, sipas versionit të fundit të listës së votuesve, siç përcaktohet në nenin 40 të LZP.
2. Në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet për kuvendet komunale dhe për kryetar të komunave, kufizimi i shpenzimeve do të jetë jo më pak se 1 euro për votues.
3. Për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave, kufizimi i shpenzimeve do të jetë jo më pak se 0.50 euro për votues.

4. KQZ, me vendim të veçantë, mund të vendos kufizim të shpenzimeve të fushatës për komunat të cilat kanë më pak se dhjetëmijë (10,000) votues të regjistruar. Kufizimi i shpenzimeve në këtë rast, nuk mund të jetë më pakë se 1.5 euro për votues.
5. Menjëherë pas certifikimit të rezultateve të raundit të parë, Zyra i rekomandon KQZ, kufizimin e shpenzimeve të fushatës sipas rekomandimit të Zyrës. KQZ merr vendim për kufizim të shpenzimeve për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave.
6. Shpenzimet maksimale për fushatë zbatohen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllime të fushatës, pa marrë parasysh kohën e blerjes apo të pajisjes me shërbime.

Neni 4

Organizimi dhe mbajtja e tubimeve publike

1. Subjekteve politike të certifikuara u ndalohet t'i mbajnë tubimet publike brenda hapësirës që shfrytëzohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet dhe agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës, ashtu siç përcaktohen në Kreun XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Subjektet politike të certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ.
3. Subjekti politik i certifikuar që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë përmes e-mailit, formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), shtojca I - Formulari për Tubimet Publike, jo më vonë se:
 - 3.1. Njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës;
 - 3.2. dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës.
4. KKZ, pas pranimit të formularit nga subjekti politik, e regjistron në libër të protokollit dhe vendos për miratim sipas datës dhe kohës së pranimit të njoftimit. KKZ, jo më vonë se ora 09:00 në ditën e tubimit e njofton policinë dhe Zyrën për qëllime të monitorimit.
5. KKZ mund të refuzojë kërkesën e subjektit politik, në rast se hapësira është e zënë më parë nga kërkesa e parashtruar nga subjekti tjetër politik.
6. Subjekti politik i certifikuar që ka marrë përgjigje negative nga një KKZ në kërkesën për mbajtjen e tubimit publik, mund të ushtrojë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), brenda njëzet e katër (24) orëve pas pranimit të përgjigjes.
7. Subjekti politik i certifikuar do ta mbajë tubimin publik, duke i respektuar të gjitha parimet ligjore me të cilat rregullohen tubimet publike, siç përcaktohet në Kapitullin V të LZP dhe Ligjit Nr. 08/L-166 për Tubimet Publike.

8. KKZ është përgjegjës të jetë në koordinim të vazhdueshëm me policinë dhe të sigurojë informim të ndërsjellë për çdo shkelje eventuale të Kodit të Sjelljes nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre gjatë tubimeve publike, sipas Kapitullit të V të LZP. Raportet e policisë në lidhje me prishjen e ndonjë ngjarje politike i vihen në dispozicion KQZ dhe PZAP. Çdo shkelje duhet që menjëherë të raportohet në PZAP dhe KQZ për veprim të mëtejshëm.
9. Subjekti politik është i obliguar të njoftojë KKZ për anulimin e tubimit të paralajmëruar.
10. Diferenca në kohë në mes të dy tubimeve në të njëjtin vend, duhet të jetë së paku dy 2 orë.
11. Çdo tubim publik i mbajtur pa e dorëzuar kërkesën apo pas refuzimit të saj nga KKZ ose policia, do të konsiderohet i paautorizuar dhe në kundërshtim me këtë Rregullore.
12. Mosmarrëveshjet në lidhje me mbajtjen e ndonjë ngjarje politike në vendet publike shqyrtohen dhe zgjidhen nga PZAP. Raportet e policisë në lidhje me trazirat në ndonjë ngjarje politike i vihen në dispozicion PZAP dhe KQZ.

Neni 5

Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve politike

1. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç përcaktohet në nenin 44 të LZP, subjektet politike të certifikuar kanë të drejtë:
 - 1.1. Të organizojnë dhe mbajnë tubime/ngjarje politike, tryeza të rumbullakëta, konferenca për shtyp, fjalime, ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm, përmes të cilave ata mund t'i shprehin lirisht mendimet e tyre me qëllim të fitimit të përkrahjes nga votuesit e tyre;
 - 1.2. të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore;
 - 1.3. të bëjnë fushatë përmes cilitdo operator televiziv, të radios apo kabllor, gjithashtu edhe përmes revistave, shtypit, portaleve, mediave elektronike, rrjetit telefonik, sistemit postar ose çdo lloj mjeti tjetër reklamues, në pajtim me rregullat e KQZ-së dhe ligjet tjera në fuqi.
2. Në fushatën e zgjedhjeve, nuk mund të përfshihen kategoritë e personave, si në vijim:
 - 2.1. Të punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike, gjatë orarit të rregullt të punës, përveç kandidatëve të certifikuar, të cilët pezullojnë vendin e punës;
 - 2.2. pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
 - 2.3. pjesëtarët e uniformuar të Policisë së Kosovës dhe personeli i tyre, përveç kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare;
 - 2.4. të punësuarit në organizatat bamirëse dhe fetare;
 - 2.5. anëtarët e KQZ, stafi i Sekretariatit të KQZ, Zyrës, KKZ, përveç në rastet kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare.

3. Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.
4. Personave të moshës gjashtëmbëdhjetë (16) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeç, ju lejohet përfshirja në aktivitetet e fushatës, vetëm me vullnetin e tyre dhe pas orarit të mësimin.
5. Subjektet politike nuk mund të shfrytëzojnë nëpunësit civilë që të përdorin pozitën, burimet apo personelin për fushatë gjatë zgjedhjeve.
6. Subjekteve politike të certifikuara u ndalohet shfrytëzimi i burimeve ose resurseve të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik.

Neni 6

Veprimet e ndaluara nga nëpunësi publik

1. Nëpunësit civil që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, për qëllime të fushatës së zgjedhjeve, ju ndalohen veprimet në vijim, siç përcaktohet me nenin 36 të LZP:
 - 1.1. Përdorimi i zyrës dhe çfarëdo infrastrukture apo pasurie të saj, me qëllim të përfitimit të votës;
 - 1.2. përdorimi i burimeve që përfshinë burime të institucionit të administratës publike të nivelit qendror, lokal ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim apo të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale.

Neni 7

Materialet e fushatës së zgjedhjeve

1. Të gjitha materialet e shtypura, ato audio vizuale dhe materialet e tjera të zgjedhjeve, përfshirë ato online, duhet ta mbajnë emrin e subjektit politik të certifikuar që e ka porositur përgatitjen e materialit të tillë.
2. Materiali i subjekteve politike nuk duhet të vendoset, si në vijim:
 - 2.1. Brenda hapësirës së institucioneve publike;
 - 2.2. shkollave;
 - 2.3. objekteve fetare;
 - 2.4. objekteve në pronësi shtetërore;
 - 2.5. në monumente;
 - 2.6. ndërtesa apo objekte të banimit, përveçme pëlqimin e banorëve, si dhe kur janë të kontraktuara;
 - 2.7. struktura dhe objekte të cilat kanë vlerë historike, kulturore, ose arkitekturore;

- 2.8. brenda ndërtesave dhe zyrave të KQZ apo të KKZ;
 - 2.9. brenda qendrave të votimit, ose në një largësi prej më pak se njëqind (100) metra nga hyrja e tyre;
 - 2.10. brenda zonave rekreative dhe parqeve;
 - 2.11. në drunj të qytetit.
3. Materialet e shtypura të zgjedhjeve, mund të ekspozohen brenda dhe jashtë objekteve në pronësi private, ndërtesave, strukturave, ose objekteve të tjera, përveç atyre të saktësuara në paragrafin 2 të këtij neni, pas miratimit paraprak të pronarëve të tyre.
 4. Subjektit politik të certifikuar i lejohet të ekspozojë materialin e vet të zgjedhjeve në atë mënyrë që, të mos e pengojë pamjen e materialeve të zgjedhjeve që u përkasin subjekteve të tjera politike të certifikuara.
 5. KKZ duhet që aktivisht ta monitorojë shfrytëzimin e materialeve të shtypura, atyre audio vizuale dhe të çfarëdo materiali tjetër të zgjedhjeve të subjekteve politike të certifikuara, gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve në raport me Kodin e Mirësjelljes për zgjedhjet dhe dispozitave tjera të përcaktuara me LZP apo rregulloret zgjedhore. Në rast të evidentimit të ndonjë shkelje, KKZ njofton menjëherë subjektin politik në fjalë që të marrë masa korrigjuese. Nëse shkelja përsëritet nga i njëjti subjekt politik ose i njëjti refuzon që t'i korrigjojë shkeljet e identifikuar, KKZ duhet ta raportojë rastin në PZAP dhe KQZ.
 6. KKZ e mirëmban listën e evidentimit të shkeljeve, si shtojcë VII – Libri i monitorimit.

Neni 8

Veprimet e ndaluara gjatë heshtjes zgjedhore

1. Nga hapja e qendrave të votimit për votim dhe deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre u ndalohen veprimet më poshtë:
 - 1.1. Mbajtja e takimeve për qëllime të fushatës së zgjedhjeve apo grumbullimi i zyrtarëve të subjektit politik të certifikuar në afërsi të qendrave të votimit;
 - 1.2. shpërndarja ose ekspozimi i çfarëdo materiali të fushatës zgjedhore në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të qendrës së votimit, duke përfshirë rrethojat;
 - 1.3. tubimi ose kërkimi i mbështetjes nga personat që hyjnë në qendrat e votimit për të votuar, në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të qendrës së votimit;
 - 1.4. shfrytëzimi i megafonave ose i sistemeve të tjera të zërimit, për t'iu drejtuar publikut kudo qoftë në Kosovë, me qëllim të ndikimit tek votuesi, ose organizimi i çfarëdo manifestimi, procesioni ose demonstratë të natyrës politike, ose pjesëmarrja në të;

- 1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi;
 - 1.6. mbajtja dhe shpërndarja e kartelave, distinktivëve apo shenjave që promovojnë subjektin politik të certifikuar apo kandidatët e tyre brenda dhe jashtë hapësirave të qendrave të votimit.
2. Ndalohet publikimi i rezultateve të anketave të hulumtimit të opinionit publik ose analizat në lidhje me qëllimet e votimit të zgjedhësve në zgjedhje, duke filluar 24 orë para hapjes së vendvotimeve deri në mbylljen e tyre.

Neni 9 Sanksionet

1. Shkeljet e Kodit të Mirësjelljes të përcaktuara në LZP, në rast kur nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve konsiderohen shkelje administrative dhe të dënueshme me gjobë nga PZAP.
2. PZAP mund t'i shqiptojë sanksione subjektit politik, kandidatit ose çdo personi, që ka shkelur dispozitat e kësaj Rregullore.
3. Në rastet kur shkeljet e Kodit të Mirësjelljes, kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, përveç sanksioneve përkatëse, shkelja procedohet në organet kompetente të sigurisë dhe drejtësisë.

Neni 10 Kontributet gjatë fushatës së zgjedhjeve

1. Kontributet për subjektet politike të certifikuara, nënkuptojnë kontributet, siç është përcaktuar në nenin 5 të LFSP.
2. Subjekti politik certifikuar mund të pranojë kontribute shtesë për fushatën e zgjedhjeve, në periudhën që fillon me shpalljen e datës së zgjedhjeve deri në ditën ku mbahen zgjedhjet.
3. Pavarësisht donacionit të rregullt brenda vitit kalendarik nga personat fizik dhe juridik, në vlerat siç përcaktohet në nenin 5 të LFSP, për fushatën e zgjedhjeve subjekti politik mund të pranojë kontribute shtesë sipas kuptimit të paragrafit 2 të këtij neni, si në vijim:
 - 3.1. Nga personi fizik, në vlerën prej, jo më shumë se dy mijë (2,000) euro;
 - 3.2. nga personi juridik, në vlerën prej, jo më shumë se dhjetë mijë (10,000) euro.
4. Për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave, subjekti politik i certifikuar i cili garon për raundin e dytë, mund të pranojë kontribute shtesë për fushatën e zgjedhjeve deri në vlerën 50% nga personi fizik dhe juridik, sipas paragrafit 3 të këtij neni, respektivisht një mijë (1,000) euro nga personi fizik dhe pesë mijë (5,000) euro nga personi juridik, pavarësisht nëse brenda vitit kalendarik subjekti politik i certifikuar ka pranuar mjete nga personat fizik dhe juridik, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

5. Subjekti politik i certifikuar që garon në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës, mund të pranojë kontribut si në paragrafin 4 të këtij neni, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të raundit të parë nga KQZ.
6. Në rast se një subjekt politik i certifikuar ka pranuar mjete financiare, përtej shumave të përcaktuara sipas kësaj Rregullore, obligohet që brenda dy (2) javësh nga data e pranimit të këtyre mjeteve, t'i kthejë ato përmes llogarisë bankare në burimin e pranimit dhe, brenda të njëjtit afat, ta informojë Zyrën.
7. Kandidatët për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kandidatët për kryetar të komunave dhe kandidatët për kuvendet komunale, që garojnë në kuadër të listës së subjektit politik të certifikuar, nuk mund të pranojnë asnjë donacion drejtpërdrejtë, por donacionet duhet të kalojnë vetëm përmes subjektit politik të certifikuar, siç përcaktohet në paragrafin 4 të nenit 11 të LFSP.
8. Kandidatët e pavarur, si subjekte politike të certifikuara, donacionet mund t'i pranojnë drejtpërdrejtë.

Neni 11 **Kontributet në holla**

1. Subjektet politike të certifikuara, për çdo kontribut të pranuar, obligohen të përfshijnë informacionin e qartë, si në vijim:
 - 1.1. Emrin dhe mbiemrin e kontribuuesit (personit fizik);
 - 1.2. adresën e kontribuuesit (personit fizik);
 - 1.3. numrin personal të identifikimit (personit fizik);
 - 1.4. data e kontributit (personit fizik);
 - 1.5. emrin e biznesit (personit juridik);
 - 1.6. emrin e pronarit të biznesit (personit fizik);
 - 1.7. emrin e pronarit përfitues të biznesit;
 - 1.8. adresën e selisë (personit juridik);
 - 1.9. numrin unik të biznesit (personit juridik);
 - 1.10. data e kontributit (personit juridik);
 - 1.11. deklaratën për prejardhjen e mjeteve.
2. Kontributdhënësi, mund të deklarojë se kontributi i tij jepet për subjektin politik të certifikuar, apo për një ose më shumë kandidatë të subjektit politik të certifikuar.
3. Subjekti politik obligohet të përfshijë informacionin se kontributi i dhënë, jepet për qëllime të fushatës së zgjedhjeve, shtojca II.
4. Personat fizik ose juridik, mund të japin donacion në para të gatshme, nën pesëdhjetë (50) euro.

Neni 12

Kontributet në natyrë

1. Subjektet politike të certifikuara, për çdo kontribut të pranuar në natyrë, obligohen të përfshijnë informacionin e qartë, duke plotësuar formularin, si shtojcë III, për pranimin e kontributit në natyrë me të dhënat, si në vijim:
 - 1.1. Përshkrimin e mallit ose shërbimit;
 - 1.2. emrin e kontribuesit, qoftë si person fizik ose juridik;
 - 1.3. adresën e kontribuuesit, duke e përfshirë emrin e rrugës dhe komunën;
 - 1.4. numrin personal të identifikimit për personin fizik, ose numrin unik të regjistrimit për personin juridik;
 - 1.5. datën kur është dhënë kontributi dhe periudha kohore e shfrytëzimit;
 - 1.6. vlerën totale në euro, sipas shumës së prezantuar në deklaratë.
2. Shërbimet e ofruara në mënyrë vullnetare nga individët për një subjekt, duke shpenzuar kohën e tyre dhe pa pagesë, nuk do të konsiderohen si kontribut.

Neni 13

Ndalimi i ndihmave financiare për subjektet politike të certifikuara

1. Subjekteve politike të certifikuara dhe kandidatëve të tyre, iu ndalohet pranimi i ndihmave financiare, siç është përcaktuar në nenin 10 të Rregullores Nr. 06/ 2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiare të Subjekteve Politike.
2. Në rast se një subjekt politik i certifikuar ka pranuar mjete financiare, siç është përcaktuar në nenin 10 të Rregullores Nr. 06/ 2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiare të Subjekteve Politike, obligohet që brenda dy (2) javësh nga data e pranimit të këtyre mjeteve, t'i kthejë ato përmes llogarisë bankare në burimin e pranimit, dhe brenda të njëjtit afat, ta informojë Zyrën.

Neni 14

Qëllimi i përdorimit të mjeteve financiare në fushatën e zgjedhjeve

1. Gjatë fushatës së zgjedhjeve, subjektet politike të certifikuara, mjetet financiare mund t'i përdorin për çfarëdo shpenzimi që ndërlidhet me aktivitetet e fushatës zgjedhore, si në vijim:
 - 1.1. Takimet ose forumet e organeve më të larta ekzekutive;
 - 1.2. takimet ose forumet e degëve;
 - 1.3. aktivitetet që kanë të bëjnë me promovimin e grave dhe të rinjve;
 - 1.4. aktivitetet e grupeve parlamentare;
 - 1.5. tubimet e fushatës së zgjedhjeve;
 - 1.6. aktivitetet në mbulimin e fushatave mediale dhe digjitale;

- 1.7. shpenzimet për hulumtimin e opinionit publik;
 - 1.8. aktivitetet që kanë të bëjnë me materialet promovuese të fushatës zgjedhore;
 - 1.9. pagesat për qiratë e zyrës, përfshirë obligimet tatimore;
 - 1.10. pagat, kompensimet, mëditjet, tatimet dhe kontributet, përfshirë vëzhguesit;
 - 1.11. shpenzimet për telefoni dhe internet;
 - 1.12. shpenzimet e shërbimeve komunale;
 - 1.13. mirëmbajtjen e pajisjeve dhe hapësirës;
 - 1.14. organizimin e punëtorive;
 - 1.15. ekskursione dhe aktivitete kulturore, rekreative/ sportive;
 - 1.16. shpenzimet e transportit;
 - 1.17. shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve;
 - 1.18. furnizimet për zyrat;
 - 1.19. shpenzimet bankare, taksat gjyqësore, gjobat dhe shërbimet e përmbaruesit;
 - 1.20. shpenzimet e përfaqësimit;
 - 1.21. shpenzimet tjera që kanë të bëjnë me fushatën e zgjedhjeve.
2. Të gjitha subjektet politike, me rastin e aplikimit për certifikim, obligohen ta kenë vetëm një llogari bankare aktive, përmes së cilës do t'i realizojnë transaksionet bankare.
 3. Nëse subjekti politik i certifikuar nuk ka llogari bankare, obligohet që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas certifikimit nga KQZ, ta hap llogarinë bankare në njërin nga bankat komerciale.

Neni 15

Deklarimi financiar i fushatës së zgjedhjeve

1. Subjekti politik i certifikuar, obligohet ta dorëzojë në Zyrë raportin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, shtojca V, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendrike pas certifikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ, siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 41 të LZP.
2. Raporti i deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve duhet të përmbajë të dhënat, si në vijim:
 - 2.1. Të dhënat e subjektit politik;

- 2.1.1. emrin e subjektit politik;
 - 2.1.2. akronimin (nëse ka);
 - 2.1.3. adresa e selisë qendrore të subjektit politik (rruga, numri, kodi postar dhe komuna);
 - 2.1.4. periudha e raportimit;
 - 2.1.5. numri i regjistrimit për qëllime të tatimit (NRF);
 - 2.1.6. emri i bankës komerciale dhe numri i llogarisë bankare.
- 2.2. Të dhënat e përfaqësuesit të autorizuar financiar;
- 2.2.1. emri dhe mbiemri;
 - 2.2.2. numri personal i identifikimit;
 - 2.2.3. adresa e vendbanimit (rruga dhe numri);
 - 2.2.4. numri i telefonit kontaktues;
 - 2.2.5. adresa elektronike (e-mail).
- 2.3. Të dhënat për kryetarin e subjektit politik;
- 2.3.1. emri dhe mbiemri;
 - 2.3.2. numri personal i identifikimit;
 - 2.3.3. adresa e vendbanimit (emri i rrugës, numri dhe komuna);
 - 2.3.4. komuna e vendbanimit;
 - 2.3.5. numri i telefonit kontaktues;
 - 2.3.6. adresa elektronike (e-mail)
- 2.4. Në mungesë të kryetarit të subjektit politik të certifikuar, raporti i deklarimit financiar i fushatës së zgjedhjeve mund të nënshkruhet nga anëtari i organit më të lartë ekzekutiv, përmes autorizimit të dhënë nga kryetari, apo siç është e paraparë me statut, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe vulosur.
- 2.4.1. Nënshkrimi nga personi i autorizuar në emër të kryetarit të subjektit politik, vlen vetëm për dorëzimin e raportit të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve dhe kryetari i subjektit politik të certifikuar mbetet përgjegjës për përmbajtjen e raportit të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve.

- 2.5. një fletë bilanci që paraqet pasuritë, detyrimet dhe barazimin e subjektit prej ditës së parë, deri te dita e fundit e periudhës së raportimit;
 - 2.6. taksën e certifikimit për subjektet politike të certifikuara, të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës;
 - 2.7. të ardhurat e subjektit politik për periudhën raportuese, përfshirë burimin dhe datën e të gjitha kontributeve;
 - 2.7.1. për kontributet e pranuar në të holla, subjekti politik i certifikuar duhet të dorëzoj të dhënat dhe dëshmitë si në vijim: vlerën e pranuar, shënimin se kontributi është dhënë për qëllime të fushatës së zgjedhjeve, deklaratën e nënshkruar nga kontribuuesi, qarkullimin bankar që dëshmon se kontributi është pranuar përmes transaksionit bankar;
 - 2.7.2. për kontributet e pranuar në natyrë, subjekti politik i certifikuar duhet të dorëzoj deklaratën që përcakton vlerën e tregut të çdo produkti apo shërbimi të dhuruar për subjektin politik.
 - 2.8. Të gjitha shpenzimet, përfshirë shpenzimet e fushatës, të bëra nga subjekti gjatë periudhës raportuese, që përmban:
 - 2.8.1. faturat dhe kuponët për të gjitha shpenzimet, të cilat i ka kryer subjekti ndaj personit tjetër fizik ose juridik, qëllimi i pagesës, përfshirë dokumentet mbështetëse, kur kërkohen;
 - 2.8.2. qarkullimin bankar për periudhën e raportimit;
 - 2.9. kontratat, partner i të cilave është subjekti politik i certifikuar, përfshirë kontratat lidhur me qiranë ose blerjen e pasurisë së tundshme dhe të patundshme;
 - 2.10. listën e pagave për të gjithë stafin i cili paguhet përgjatë fushatës së zgjedhjeve mëditjet, tatimet dhe kontributet;
 - 2.11. listën e pagesave për vëzhguesit, të cilët paguhen për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve, përfshirë tatimet;
 - 2.12. qarkullimin bankar për realizimin e pagesave si në nënparagrafët 5 dhe 6 të këtij neni;
3. Deklarimi financiar i fushatës së zgjedhjeve edhe aktivitetet zgjedhore, fillon me shpalljen e datës së zgjedhjeve dhe përfundon në ditën e zgjedhjeve, para hapjes së qendrave të votimit.
 4. Çdo subjekt politik i certifikuar, në raportin e deklaramit financiar të fushatës së zgjedhjeve dhe aktiviteteve zgjedhore, duhet të përveç shpenzimeve organizative zgjedhore, edhe shpenzimet e kandidatëve për deputet, kandidatëve për kryetar të komunave dhe kandidatëve për kuvendet komunale.
 5. Shpenzimet e fushatës së zgjedhjeve për kandidatët për deputet, kandidatët për kryetar të komunave dhe kandidatët për kuvendet komunale, realizohen nga subjekti politik, në emër të të cilit janë certifikuar.

6. Kandidatët për deputetë, kandidatët për kryetar të komunave dhe kandidatët për kuvendet komunale mund të pranojnë kontribute në natyrë për shpenzimet në emër të tyre, për rrjetet sociale, mediat e shkruara, mediat vizuale, derivate, materiale promovuese dhe shpenzime tjera.
7. Kontributet në natyrë, si në paragrafin 6 të këtij neni, kandidatët i deklarojnë tek subjekti politik, në emër të të cilit janë certifikuar dhe të njëjtat deklarohen si shpenzime të fushatës së subjektit politik.
8. Për raundin e dytë të zgjedhjeve deklarimi financiar i fushatës përfshinë periudhën deri në ditën e zgjedhjeve, për ato subjekte që garojnë në zgjedhje.
9. Zyra obligohet që pas certifikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ, t'i njoftojë përfaqësuesit e autorizuar të subjekteve politike të certifikuar për datën e fundit të dorëzimit të raporteve të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve.
10. Subjektet politike të certifikuar në zgjedhjet lokale, të cilat nuk marrin pjesë në raundin e dytë të zgjedhjeve, obligohen që raportet e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, t'i dorëzojnë në Zyrë, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga KQZ.
11. Raportet e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve duhet të përmbajnë të dhënat, si në vijim:
 - 11.1. Përfaqësuesi i autorizuar financiar dhe kryetari i subjektit politik obligohen që ta nënshkruajnë deklaratën se të dhënat e publikuara në formularin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve janë të sakta, të plota dhe në përputhje me ligjet në fuqi dhe rregullat e KQZ, e cila është e bashkangjitur si pjesë e shtojcës V.
12. Raporti i deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, nënshkruhet nga kryetari i subjektit politik të certifikuar, si koalicion, nismë qytetare apo kandidat i pavarur dhe autorizimi për nënshkrim nuk mund të bartet tek personat tjerë.
13. Zyra obligohet që pas certifikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ, t'i njoftojë përfaqësuesit e autorizuar të subjekteve politike të certifikuar për datën e fundit të dorëzimit të raporteve të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve.
14. Nëse subjektet politike të certifikuar, të regjistruara në regjistrin e partive politike, nuk e dorëzojnë raportin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve brenda periudhës së përcaktuar si në paragrafin 1 të këtij neni, përveç shqiptimit të gjobës, Zyra i rekomandon KQZ pezullimin e subjektit politik.
15. Subjekti politik obligohet që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas pranimit të vendimit për pezullim, ta dorëzojë raportin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve në Zyrë.
16. Nëse subjekti politik nuk e dorëzon raportin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, brenda afatit të përcaktuar në vendimin për pezullim, KQZ sipas rekomandimit të Zyrës, merr vendim për çregjistrimin e subjektit politik nga regjistri.

17. Nëse subjekti politik i certifikuar, që ka fituar ulëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nuk e dorëzon raportin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, KQZ nuk do t'i transferojë mjetet financiare nga Fondi deri në momentin kur subjekti e dorëzon raportin në Zyrë.
18. Raportet e deklarimit financiar të fushatës, do të krahasohen me raportet e monitorimit dhe në rast se raportet e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve përmbajnë të dhëna të ndryshme me raportet e monitorimit, subjektit politik të certifikuar i jepet mundësia që ta përmirësoj raportin dhe të përmirësuar, ta dorëzoj në Zyrë.

Neni 16

Mirëmbajtja dhe ruajtja e dokumentacionit mbështetës

1. Subjekti politik i certifikuar ruan dokumentet mbështetëse në funksion të realizmit të aktiviteteve të fushatës së zgjedhjeve, që përfshinë faturat dhe kuponët për të gjitha shpenzimet, të cilat i ka kryer subjekti ndaj personit tjetër fizik ose juridik, qëllimi i pagesës, përfshirë dokumentet mbështetëse, kur kërkohen.
2. Dokumentet si në paragrafin 1 të këtij neni, ruhen për një periudhë jo më gjatë se shtatë (7) vite, siç përcaktohet me paragrafin 6 të nenit 41 të LZP.

Neni 17

Monitorimi i fushatës së zgjedhjeve nga KQZ

1. Monitorimi i fushatës së zgjedhjeve, fillon tridhjetë (30) ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përfundon me hapjen e qendrave të votimit në ditën e zgjedhjeve.
2. Monitorimi i fushatës së zgjedhjeve në periudhën e përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të realizohet nga Zyra, përmes zyrtarëve të angazhuar nëpër komunat e Republikës së Kosovës.
3. Përgjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve, Zyra do të monitorojë:
 - 3.1. Organizmin e takimeve, veprimtarive e tubimeve të fushatës së zgjedhjeve;
 - 3.2. zyrat e subjekteve politike të certifikuara;
 - 3.3. billboardët, posterët dhe materialet tjera promovuese të subjekteve politike të certifikuara.
4. Monitoruesi në baza ditore monitoron ngjarjet politike, mbledh informacione për to si dhe sigurohet që e njëjta është e miratuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ).
5. Për monitorimin e fushatës së zgjedhjeve, siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni, monitoruesit nëpër komunat e Republikës së Kosovës, obligohen që raportin me shkrim, shtojca VI, ta dërgojnë në Zyrë, jo më vonë se një ditë pas ngjarjes së monitoruar.
6. Raporti i monitorimit do të përmbajë:
 - 6.1. Lloji i zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve;

- 6.2. emrin e komunës, ku ka ndodhur monitorimi;
 - 6.3. a është i miratuar tubimi nga KKZ;
 - 6.4. emrin e subjektit politik të certifikuar;
 - 6.5. emrin i rrugës, emrin e objektit dhe lokacionin ku është realizuar monitorimi;
 - 6.6. përshkrimin e ngjarjes që është monitoruar, varësisht nga lloji i monitorimit,
 - 6.6.1 për tubime, takime dhe aktivitete tjera: të gjithë inventarin, materialet promovuese dhe rekuizitat, paisjet teknologjike (led ekran, skenë, ndriçim, zërim, etj.) transporti (autobusët) ushqimi dhe pijet;
 - 6.6.2 për zyrat: lokacioni, inventari dhe paisjet e zyrës;
 - 6.6.3 për materialet promovuese: sasinë, llojin dhe pajtueshmërinë me Kodin e Mirësjelljes.
 - 6.7. imazhet nga monitorimi;
 - 6.8. emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e monitoruesit;
 - 6.9. adresën elektronike dhe numrin e kontaktit të telefonit;
 - 6.10. kohëzgjatjen e saktë të periudhës së monitorimit.
7. Raportet e monitorimit do të shfrytëzohen si informacione vetëm për këto qëllime:
- 7.1. evidentimi dhe krahasimit me të dhënat e deklaruara në raportin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve nga subjekti politik i certifikuar;
 - 7.2. mbledhjen e informatave dhe evidentimin me qëllim të respektimit të Kodit të Mirësjelljes së LZP dhe rregulloreve të KQZ.
8. Zyra mund të kërkoj informata edhe nga Këshilli për Mediat e Shkruara të Kosovës (KMSHK).

Neni 18

Monitorimi dhe raportimi i Komisionit të Pavarur për Media

1. Monitorimi i fushatës së zgjedhjeve për subjektet politike dhe kandidatët e tyre, behët nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), siç përcaktohet në kapitullin VIII të LZP, si në vijim:
 - a. Mediat audiovizuale (TV) me transmetim tokësor;
 - b. mediat audiovizuale (TV) me operator të shpërndarjes;

- c. mediat audio (Radio) me transmetim tokësor;
 - d. komunikimin digjital (fushatën online), që përfshin rrjetet sociale;
 - e. mediat e shkruara.
2. Pas certifikimit të subjekteve politike nga KQZ, Zyra do t'i dërgojë KPM, të dhënat për subjektet politike të certifikuar dhe kandidatët e certifikuar.
 3. Jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas ditës së votimit, Zyra kërkon nga KPM raportet me informacionet e monitorimit, që përfshijnë:
 - 3.1. Emrin e subjektit politik të certifikuar;
 - 3.2. emrin e mediumit që ka transmetuar material të sponsorizuar;
 - 3.3. koha e transmetimit;
 - 3.4. çmimin;
 - 3.5. lloji i publikimit apo transmetimit;
 - 3.6. të dhëna tjera që specifikohen në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes KQZ dhe KPM.
 4. Raportet e monitorimit të pranuar nga KPM, do të shfrytëzohen si informacion për qëllime të krahasimit me të dhënat e deklaruara në raportin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve.
 5. KQZ dhe KPM nënshkruajnë marrëveshje mirëkuptimi, me qëllim të zbatimit të obligimeve të ndërsjella në monitorimin e fushatës së zgjedhjeve.

Neni 19

Kontrolli financiar

1. Raportet e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, auditohen në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.
2. Auditimi i raporteve të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, kryhet nga auditorët ligjorë.
3. Zyra përzgjedh auditor të licencuar ligjor, të cilët do të auditojnë Raportet e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, të cilët ndërmarrin veprime në emër të Zyrës.
4. Pas përzgjedhjes së auditorëve, të cilët do të bëjnë auditimi nga paragrafi 3 i këtij neni, Zyra nga kjo listë do të caktojë me short auditorët të cilët do të jenë përgjegjës për auditimin e raporteve të subjekteve politike dhe tre (3) auditorë në listën rezervë.

5. Zyra mund të iniciojë një verifikim të pajtueshmërisë për shkeljet e dëshmive nën betim të auditorëve, si shtojcë IV.
6. Subjekti politik i certifikuar, obligohet t'i përmbushë kërkesat ligjore të parapara me paragrafët 6 dhe 7 të nenit 19 të LFSP.
7. Për qëllim të auditimit të raporteve të fushatës, auditorëve ligjorë do t'ju vihen në dispozicion raportet e monitorimit të fushatës nga monitoruesit e Zyrës
8. Auditori mund të arrijë në përfundimin se subjekti politik i certifikuar nuk ka bashkëpunuar plotësisht, në rast se:
 - 8.1. I kufizohet qasja në hapësirat e subjektit politik, ku mirëmbahen shënimet financiare, pas tri tentimeve, pavarësisht nga arsyetimi i dhënë nga subjekti politik;
 - 8.2. mos përgjigja ndaj kërkesave apo mosofrimi i dokumenteve të kërkuara, në një periudhë kohore më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë;
 - 8.3. raste të tjera të mos bashkëpunimit, që pamundësojnë kryerjen e auditimit.
9. Për mosbashkëpunimin sipas paragrafit 7 të këtij neni, auditori obligohet ta dëshmojë përmes korrespondencës me shkrim që ka pasur me përfaqësuesit e autirozuar të subjektit politik dhe ta informojë Zyrën për këtë.
10. Zyra heton rastet e mos bashkëpunimit dhe në rast se konstaton konkluzionin e auditorit për subjektin politik të certifikuar që ka fituar ulëse në Kuvendin e Kosovës, i rekomandon KQZ që të nxjerrë vendim për ta privuar subjektin në fjalë nga përfitimi i fondit që ndahet nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin vijues.
11. Auditimi i raporteve të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve zhvillohet në periudhën kohore si në vijim:
 - 11.1. Auditimi i raporteve të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, fillon jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ;
 - 11.2. procesi i auditimit deri në përfundim të tij, përcaktohet nga Zyra me marrëveshjen me auditorin, që përshinë këto aktivitete të auditimit:
 - 11.2.1. Fillimin e auditimit;
 - 11.2.2. hartimi i raporteve preliminare të auditimit;
 - 11.2.3. dërgimi i raporteve preliminare të auditimit tek përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, që përshinë periudhën e komenteve;
 - 11.2.4. hartimi i raporteve përfundimtare;
 - 11.2.5. publikimi i raporteve përfundimtare.

12. Pas publikimit të raporteve përfundimtare të audituara të deklarimit financiar të fushatës, Zyra harton raportin përfundimtar për KQZ, me të gjeturat e dala nga procesi i auditimit dhe rekomandimet që Zyra nxjerr me qëllim të avancimit të mëtejshëm të mekanizmave për financimin e subjekteve politike, sidomos në aspektin e ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies. Raporti do të përmbajë të dhënat për shqiptimin e gjobave.
13. Për subjektet politike të certifikuara, Zyra i dorëzon Raportet Përfundimtare të Auditimit në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, dhe/ ose agjencive tjera të zbatimit të ligjit, përfshirë Agjencinë Kundër Korrupsionit, Njësinë e Inteligjencës Financiare ose Administratën Tatimore të Kosovës, kur dyshimi për parregullsi bie nën kompetencën e njëres ose më shumë institucioneve të renditura më lartë.

Neni 20

Publikimi i raporteve të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve

1. Zyra obligohet që raportet e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, t'i publikojë në ueb faqen zyrtare të KQZ, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë (15) nga dita e pranimit.
2. Subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, sipas rezultateve të zgjedhjeve të fundit, obligohen t'i publikojnë raportet e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve në ueb faqet e tyre funksionale, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas dorëzimit në Zyrë.
3. Subjektet politike të cilat kanë fituar ulëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat nuk kanë qenë të përfaqësuara në legjislaturën e fundit, obligohen që ta krijojnë ueb faqen funksionale zyrtare, brenda tridhjetë (30) ditësh pas certifikimit të rezultateve nga KQZ, me qëllim të publikimit të raporteve të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve.
4. Publikimi i raporteve të deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, nga subjektet politike dhe nga Zyra, duhet të bëhet në përputhje me mbrojtjen e të dhënave personale sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 21

Dispozitat ndëshkuese

1. Zyra shqipton gjoba në përputhje me dispozitat e LFSP dhe akteve nënligjore, ndaj subjekteve politike dhe ndaj personave të saj përgjegjës, kandidatëve për kryetarë të komunave, kandidatëve tjerë të pavarur dhe çdo personi tjetër juridik ose fizik që e shkel LFSP dhe ligjet ose aktet tjera nënligjore përkatëse.
2. Njësia përgjegjëse në Zyrë, harton rekomandimet për shqiptimin e gjobave, në bazë të të cilave Drejtori i Zyrës merr vendimin për shqiptimin e gjobave.
3. Mjetet e mbledhura nga gjobat derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Shqiptimi i gjobës ose i ndonjë sanksioni tjetër nga ana e Zyrës, nuk paragjykon aplikimin e ndonjë sanksioni penal ose ndonjë pasoje tjetër.

5. Nëse subjekti politik i certifikuar, përfitues i mjeteve financiare që ndahen nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike (Fondi) i ka përdorur në kundërshtim me nenin 4 të Rregullores Nr. 06/ 2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiarë të Subjekteve Politik, dhe nenin 14 të kësaj Rregulloreje, i shqiptohet gjobë prej pesë mijë (5,000) euro deri në dhjetëmijë (10,000) euro.
6. Përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, si kryetari i subjektit politik dhe përfaqësuesi financiar i subjektit politik, sipas paragrafit 5 të këtij neni, gjobiten me nga njëmijë (1,000) euro secili.
7. Subjektet politike të certifikuara, të cilat kanë dy (2) ose më shumë llogari bankare për të hyrat për financimin e fushatës së zgjedhjeve në kundërshtim me nenin 4 të LFSP, me kushtin që gjatë periudhës së fushatës ka realizuar transaksione bankare, gjobiten si në vijim:
 - 7.1. Subjektet politike që përfitojnë mjete financiar nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, si pjesë e koalicionit, gjobiten në vlerën tetëmijë (8,000) euro;
 - 7.2. subjektet politike të regjistruara, që janë certifikuar në zgjedhje, gjobiten në vlerën katërmijë (4,000) euro;
 - 7.3. subjekti politik i certifikuar si nismë qytetare, si koalicion, apo si kandidat të pavarur, gjobiten në vlerën katërmijë (4,000) euro.
8. Përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, si kryetari i subjektit politik dhe përfaqësuesi financiar i subjektit politik, sipas paragrafit 7 të këtij neni, gjobiten me nga njëmijë (1,000) euro secili.
9. Nëse në llogarinë e dytë bankare ose më shumë, ka transaksione të realizuara mbi vlerën pesëmijë (5,000) euro përgjatë fushatës, Zyra do të realizojë inspektimin e asaj llogarie bankare.
10. Subjekti politik i certifikuar, i cili nuk i ka mbajtur evidencat dhe nuk ka lëshuar dëftesë për pagesat e anëtarësimit dhe pagesat vullnetare, për kontributet jo financiare, pagesën e huave dhe kontributeve në natyrë, gjobiten si në vijim:
 - 10.1. Subjektet politike të certifikuara që kanë qenë përfituese të mjeteve financiare nga Fondi, gjobiten në vlerën prej katërmijë (4,000) euro deri në dhjetëmijë (10,000) euro;
 - 10.2. subjektet politike të regjistruara, që janë certifikuar në zgjedhje, gjobiten në vlerën katërmijë (4,000) euro;
 - 10.3. subjektet politike të certifikuara, si nismë qytetare, si koalicion, apo si kandidat të pavarur, gjobiten në vlerën katërmijë (4,000) euro.
11. Përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, si kryetari i subjektit politik dhe përfaqësuesi financiar i subjektit politik, sipas paragrafit 10 të këtij neni, gjobiten me nga njëmijë (1,000) euro secili.
12. Nëse subjekti politik i certifikuar, ka tejkaluar kufizimin e shpenzimeve të fushatës së zgjedhjeve të vendosur nga KQZ, gjobitet në dyfishin e vlerës së tejkaluar, por jo më pak se katërmijë (4,000) euro.

13. Përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, si kryetari i subjektit politik dhe përfaqësuesi financiar i subjektit politik, sipas paragrafit 12 të këtij neni, gjobiten me nga një mijë (1,000) euro secili.
14. Subjekti politik i certifikuar, i cili ka dorëzuar raportin e deklarimit financiar të fushatës me të dhëna të pasakta dhe jo të plota, sipas nenit 41 të LZP, gjobitet si në vijim:
 - 14.1. Subjektet politike të certifikuar që kanë qenë përfituese të mjeteve financiare nga Fondi, gjobiten në vlerën prej katërmijë (4,000) euro deri në dhjetë mijë (10,000) euro;
 - 14.2. subjektet politike të regjistruara, që janë certifikuar në zgjedhje, gjobiten në vlerën katërmijë (4,000) euro;
 - 14.3. subjektet politike të regjistruar, si nismë qytetare, si koalicion, apo si kandidat i pavarur, gjobiten në vlerën katërmijë (4,000) euro.
15. Përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, si kryetari i subjektit politik dhe përfaqësuesi financiar i subjektit politik, sipas paragrafit 14 të këtij neni, gjobiten me nga një mijë (1,000) euro secili.
16. Subjekti politik i certifikuar, i cili nuk e dorëzon raportin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, sipas afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 16 të kësaj Rregullore, gjobitet në vlerën pesë mijë (5,000) euro.
17. Përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, si kryetari i subjektit politik dhe përfaqësuesi financiar i subjektit politik, sipas paragrafit 16 të këtij neni, gjobiten me nga një mijë (1,000) euro secili.
18. Nëse subjektet politike të certifikuar nuk kanë dhënë qasje për auditorët nëpër zyra dhe në libra (evidencat) ku të dhënat mbahen, gjobiten si në vijim:
 - 18.1. Subjekti politik i certifikuar, që ka qenë përfitues i mjeteve financiare nga Fondi, gjobitet në vlerën prej katërmijë (4,000) euro deri në dhjetë mijë (10,000) euro;
 - 18.2. subjekti politik i certifikuar si subjekt politik i regjistruar, gjobitet në vlerën katërmijë (4,000) euro;
 - 18.3. subjekti politik i certifikuar si nismë qytetare, si koalicion, apo si kandidat i pavarur, gjobitet në vlerën katërmijë (4,000) euro.
19. Përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, si kryetari i subjektit politik dhe përfaqësuesi financiar i subjektit politik, sipas paragrafit 18 të këtij neni, gjobiten me nga një mijë (1,000) euro secili.
20. Nëse subjekti politik i certifikuar ka pranuar kontribut në kundërshtim me nenin 10 të kësaj Rregullore, dhe nuk ka marrë veprimet për kthimin e mjeteve, siç përcaktohet me paragrafin 6 të nenit 10 të kësaj Rregullore, gjobitet si në vijim:

- 20.1. Për donacionin e pranuar nga personi fizik, Zyra shqipton gjobën ndaj subjektit politik të certifikuar në dyfishin e vlerës së tejkaluar, por jo më pak se katërmijë (4,000) euro;
- 20.2. për donacionin e pranuar nga personi juridik, Zyra shqipton gjobën ndaj subjektit politik të certifikuar në dyfishin e vlerës së tejkaluar, por jo më pak se katërmijë (4,000) euro.
21. Përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, si kryetari i subjektit politik dhe përfaqësuesi financiar i subjektit politik, sipas paragrafit 20 të këtij neni, gjobiten me nga njëmijë (1,000) euro secili.
22. Subjekti politik, i cili ka pranuar kontribut nga personat ose institucionet e parapara në nenin 11 të LFSP, obligohet që mjetet t'i kthejë te kontribut dhënësi, brenda dy (2) javësh, pas ditës së pranimit dhe ta njoftojë Zyrën.
 - 22.1. Në rast se ka dëshmi, se mjetet financiare janë pranuar nga organizatat terroriste të shpallura nga institucione ndërkombëtare dhe organizata që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, integritetin dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës, Zyra ndërmer veprime dhe njofton institucionet kompetente për ngrirjen e fondeve dhe transferimin e tyre në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
23. Nëse subjekti politik nuk i kthen mjetet brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 22 të këtij neni, Zyra në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, ndërmer veprime për tërheqjen dhe transferimin e mjeteve në buxhetin e Republikës së Kosovës.
24. Pavarësisht veprimeve sipas paragrafit 23 të këtij neni, subjekti politik gjobitet me dyfishin e vlerës së pranuar, por jo më pak se katërmijë (4,000) euro dhe jo më shumë se dyzetmijë (40,000) euro.
25. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara, që janë certifikuar si koalicion, janë të obliguara ta ndajnë në mënyrë të barabartë shumën e gjobës për pagesë, siç përcaktohet në paragrafin 3 të nenit 19 të LZP.
26. Secili kandidat i certifikuar i listës së nismës qytetare, është përgjegjës për ndarjen e barabartë të gjobës për pagesë, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 20 të LZP.
27. Gjobat e shqiptuara sipas këtij neni, paguhen individualisht nga përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, varësisht se kujt iu është shqiptuar gjoba dhe jo nga mjetet financiare të subjektit politik.
28. Personave fizik dhe personave juridik, iu shqiptohen gjobat, siç përcaktohet në paragrafët 27 dhe 28 të nenit 15 të Rregullores Nr. 06/ 2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiare të Subjekteve Politike.
29. Kandidatit për kryetar të komunës, kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kandidatit për Kuvendin Komunal, i shqiptohet gjobë prej njëmijë (1,000) euro deri në dhjetëmijë (10,000) euro, për shkeljet e parapara në paragrafin 6 të nenit 21 të LFSP, si në vijim:

- 29.1. Nëse nuk i ka deklaruar kontributet në natyrë tek subjekti politik, siç përcaktohet me paragrafin 6 dhe 7 të nenit 15 të kësaj Rregullore, gjobiten në vlerën një mijë (1,000) euro;
- 29.2. nëse dëshmohet se ka pranuar direkt donacione në të holla, gjobiten në dyfishin e vlerës së pranuar, por jo më pak se një mijë (1,000) euro dhe jo më shumë se dhjetë mijë (10,000) euro;
- 29.3. nëse ka pranuar ndihma financiare dhe materiale siç përcaktohet në nenin 11 të LZP, gjobitet jo më pak se një mijë (1,000) euro dhe jo më shumë se tetë mijë (8,000) euro.
30. Kandidati për kryetar të komunës, kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kandidatit për Kuvendin Komunal, gjobat e shqiptuara, siç përcaktohet në paragrafin 29 të këtij neni, obligohen ta paguajnë individualisht, dhe jo nga mjetet financiare të subjektit politik.

Neni 22 Ekzekutimi i gjobave

Për ekzekutimin e gjobave për shkeljet e përcaktuara në nenin 21 të kësaj Rregullore, zbatohen dispozitat e nenit 16 të Rregullores Nr. 06/ 2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiare të Subjekteve Politike.

Neni 23 Mbikëqyrja financiare

Dispozitat e përcaktuara sipas nenit 17 të Rregullores Nr. 06/ 2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiare të Subjekteve Politike, vlejnë edhe për subjektet politike të certifikuara.

Neni 24 Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla Nr. 07/ 2023 Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 12/ 2013 Kufizimi i Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar.
2. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë shtojcat:
 - shtojca - I Formulari për Tubimet Publike;
 - shtojca - II Lista e kontribuuesve në të holla;
 - shtojca - III Lista e kontribuuesve në natyrë;
 - shtojca - IV Deklarata nën betim;
 - shtojca - V Raporti i deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve;

shtojca - VI Raporti i monitorimit të fushatës së zgjedhjeve;

shtojca - VII Libri i monitorimit.

3. Zyra, jo më vonë se një (1) vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore zhvillon platformën elektronike që mundëson evidentimin dhe raportimin e shpenzimeve në mënyrë të sistematizuar nga secili subjekt politik.

Neni 25 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

Kreshnik Radoniqi

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve